



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË

Himarë, më 12.07 . 2024

Lënda: Kthim përgjigjeje të kërkesës suaj për informacion në platformën elektronike e-mail datë 08.07.2024.

Në përgjigje të kërkesës suaj të datës 08.07.2024 ardhur me postë elektronike (e-mail) , ku kërkohet “Kërkesë për informacion” pranë Bashkisë Himarë. Për sa më sipër po ju përgjigjemi pyetjeve sipas renditjes së bërë në kërkesën tuaj:

1-Të më vendoset në dispozicion Plani i Veprimit për Eficiencën e Energjisë, në bashkinë tuaj.

Ende nuk ka një plan të miratuar.

2- Cilat janë hapat e ndërmarrë për zbatimin e këtij plani (buxheti në dispozicion, aktivitete, politika, etj.)

Në përputhje me VKB nr 62 datë 21.12.2023 Për buxhetin e vitit 2024 të Bashkisë Himarë, këshilli bashkiak ka parashikuar investime si më poshtë:

Eficienca Energjitime e Objekteve Funktionale të Bashkisë 10.000.000 lekë

Instalim impiante fotovoltaik në godinat e Bashkisë 10.000.000 lekë

3- Nëse ky dokument nuk është hartuar ende, cilat janë arsyet?

Bazuar ligjit 124/2015 për Eficiencën e Energjise, i ndryshuar dhe VKM 872 dt 28.12.2021 “Për miratimin e planit kombëtar për energjinë dhe klimën 2020-2023” Bashkia Himarë është në proces përpunimi të planit vendor të veprimit për eficiencën e energjisë por ende nuk ka propozuar këshillit bashkiak projektvendimin përkatës i cili parashikohet të dërgohet këtë vit ushtrimor.

4- Çfarë hapash parashikohet të ndërmerren në të ardhmen për zbatimin/hartimin e

Planit të Veprimit për Eficiencën e Energjisë?

Hapat që parashikohen të ndërmerret në të ardhmen për zbatimin/hartimin e Panit të Veprimit për Eficiencën e Energjisë janë:

Degjesat publike ,ngritje e grupit te punës si dhe paraqitjen e projektvendimit në këshillin bashkiak të Planit të Veprimit për Eficiencën e Energjisë.

Ju falenderojmë për mirëkuptimin!